

R E L A C I O N

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË
PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, NDËRMJET
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “SICPA SECURITY SOLUTIONS”
SA E “SICPA SECURITY SOLUTIONS ALBANIA”, SH.P.K.,
PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, DIZENJIMIN, PRODHIMIN
DHE NGRITJEN E NJË SISTEMI PËR EMETIMIN, SHPËRNDARJEN,
GJETJEN DHE MONITORIMIN E PULLAVE FISKALE
E TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE, MIRATUAR
ME LIGJIN NR.10381, DATË 24.2.2011”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është miratimi i kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “*SICPA Security Solutions*” SA e “*SICPA Security Solutions Albania*” sh.p.k., për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011. Kjo kontratë shtesë është dakordësuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve kontraktore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij projektligji.

Kontrata shtesë synon të rregullojë marrëdhëniet e palëve të kësaj kontrate koncesioni, duke zgjidhur përfundimisht problematikën e mosrealizimit nga ana e autoritetit kontraktor të një pjese të objektit të kontratës që lidhet me pullat e kontrollit të produkteve farmaceutike, objekt i cili nuk është realizuar që në fillim të implementimit të kontratës koncesionare. Mosrealizimi i objektit është ngritur si pretendim nga shoqëria koncesionare në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë viteve të zbatimit të kësaj kontrate. Nëpërmjet këtij projektligji synohet përmbyllja përfundimtare e kësaj kontrate koncesioni dhe krijimi i kushteve dhe veprimeve procedurale në vijim për administrimin e këtij shërbimi të sistemit të kontrollit dhe funksionimit të pullave fiskale nëpërmjet insitucioneve publike të shtetit shqiptar.

Projektligji synon të shmangë përballjen e palëve kontraktore në Gjykatën e Arbitrazhit, e cila do të sillte pasoja financiare të konsiderueshme për shtetin shqiptar dhe synon të krijojë kushtet e përshtatshme, në mënyrë që në të ardhmen, ky shërbim të mundësohet dhe operohet nga struktura publike të shtetit shqiptar.

Gjithashtu, synohet të rregullohen disa aktivitete të kontratës me objektiv përmirësues për shtetin shqiptar, të tilla si aktivizimi i kontrollit të pullave fiskale në momentin e pagesës së detyrimeve të akcizës, pra në çastin e hedhjes për konsum në territor të produkteve të akcizës; përmirësimi i teknologjisë së implementuar *CAPEX*; ulja e çmimit të produkteve të kontratës, si dhe përfitimi i trajnimeve të strukturave shtetërore të angazhuara në kontrollin e mallrave të akcizës nga shoqëria koncesionare.

Në përputhje me kontratën ekzistuese në fuqi, sipas ligjit nr.123/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kjo kontratë shtesë miratohet me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

II. VLERËSIM I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE.

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projekakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me anë të këtij projektligji, synohet të amendohet dhe të përmbyllet kontrata e koncesionit, e miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011.

Amendimi i kësaj kontrate shtesë do të mundësojë:

- vijueshmërinë e këtij shërbimi në fushën e kontrollit fiskal në Republikën e Shqipërisë edhe pas datës 6.2.2023, datë kur kjo kontratë përfundon;
- heqjen dorë të palëve nga çdo pretendim për të gjitha vitet që nuk është përmbushur pjesa e kontratës së koncesionit, që lidhet me produktet farmaceutike;
- deklarin e *SIPCA Albania* dhe të shoqërisë “Mëmë” se nuk kanë shfaqur apo pretenduar dhe nuk do të kenë në të ardhmen asnjë pretendim apo kërkesë

ndaj autoritetit, për zbatimin e produkteve të tjera, objekt i kontratës së koncesionit, miratuar me ligjin nr.10381 datë 24.2.2011.

- që shoqëria koncesionare nuk do të ketë pretendime për kompensim, dëmshpërblim retroaktiv dhe nuk do të pretendojë ndonjë penaltet për mospërmbushje të objektit të kontratës nga ana e shtetit shqiptar;
- rivlerësimin dhe uljen e çmimeve për njësi të produkteve, të referuara në pikën 17.1 të kontratës së koncesionit, duke filluar nga data 7.2.2023;
- që shoqëria koncesionare të vazhdojë këtë kontratë, duke përdorur teknologjinë aktuale të implementuar, bazuar në kontratën e koncesionit, me përmirësime teknologjike në fushat e gjykuara si të detyrueshme për funksionalizimin e duhur operacional dhe në terren, që lidhen me platformën ekzistuese – *CAPEX*;
- krijimin e modulit të ri të raportimit të shërbimeve të të dhënave, që i mundëson autoritetit më shumë analitikë përshkruese, duke u fokusuar në atë që ka ndodhur në të kaluarën, analitikë diagnostike që ndihmon në zbulimin e arsyes se pse ndodhën gjërat dhe analitikë parashikuese që mundësojnë parashikimin e asaj që ka të ngjarë të ndodhë në të ardhmen – aktivizimi + integrimi në platformën ekzistuese;
- asistencë teknike tek autoriteti me të gjithë ekspertizën teknologjike dhe operationale të ekspertëve të shoqërisë, për vijueshmërinë dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale, 7 muaj para deri në përfundimin e afatit të kontratës së koncesionit.

Afati i kontratës koncesionare përfundon në datën 31.12.2024.

Gjatë kësaj periudhe, shoqëria koncesionare angazhohet të kryejë një investim që shkon nga 3 deri në 5 milionë euro, sipas skedulimeve që do të detajohen me afate respektive kohore në Bordin e Menaxhimit të Kontratës.

Projektligji do të adresojë zgjidhjen e problematikave të kontratës së koncesionit, për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011, dhe, përveç efekteve pozitive të sipërcituara, nuk mbart asnjë efekt negativ apo risk fiskal për shtetin shqiptar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, ligjin nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10381,

datë 24.2.2011, “Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues dhe shoqërive “*SICPA Security Solutions*” SA e “*SICPA Security Solutions Albania*” sh.p.k., për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, dhe vendimin nr.575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik/privat”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka për qëllim të përafrohet me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian, pasi bazohet vetëm në legjislacionin e brendshëm, kryesisht atë të koncesioneve dhe PPP-ve, si dhe në ligjin bazë që ka miratuar kontratën fillestare të koncesionit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 2 nene.

Neni 1 parashikon miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “*SICPA Security Solutions*” SA e “*SICPA Security Solutions Albania*”, sh.p.k., për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.201, sipas tekstit që i bashkëlidhet projektligjit.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi.

Kontrata shtesë, e dakordësuar ndërmjet palëve të kontratës së koncesionit, përmban si më poshtë:

Pika 1 “Ndryshime në kontratën e koncesionit”

- **Neni 3.2** i marrëveshjes së koncesionit ndryshon afatin e kontratës koncesionare, duke përcaktuar se: “Koncesioni jepet për një periudhë, që fillon në datën efektive dhe mbaron më 31 dhjetor 2024 (“Afati”) me kusht që, nëse kjo kontratë përfundon më shpejt sipas kushteve të saj, “Afati” do të nënkuptojë dhe do të kufizohet në periudhën që fillon në datën efektive dhe

mbaron në datën e përfundimit të kësaj kontrate, në përputhje me termat e saj.”.

- **Neni 17.1** i Marrëveshjes së koncesionit reflekton çmimet e reja të produkteve, objekt kontrate, duke sanksionuar se: “Palët bien dakord se çmimeve për njësi të produkteve, të referuara në pikën 17.1 të kontratës së koncesionit do t’u aplikohet një zbritje prej 10%, duke filluar nga data 7.2.2023”.
- Duke qenë se palët heqin dorë nga çdo pretendim për produktet e farmaceutikës, aneksi 1, i kontratës së koncesionit, ndryshon, si më poshtë:

“Në aneksin 1 të kontratës së koncesionit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) “Produkte(t) quhen produktet e duhanit, produktet e distiluara dhe të fermentuara të alkoolit, duke përfshirë birrën dhe produkte të tjera që i shtohen qëllimit të shërbimeve kohë pas kohe, në përputhje me nenin 3.6, të kësaj kontrate”;
 - b) Fshihet çdo reference e bërë lidhur me “Produktet farmaceutike”.
- Në këtë pikë është hequr çdo përcaktim apo referencë në marrëveshjen bazë për sa i përket produkteve farmaceutike: “Çdo përcaktim apo referencë tjetër në kontratën e koncesionit për “Produktet farmaceutike fshihet.”.

Pika 2 “Detyrime e angazhime të tjera ndërmjet palëve”

- Palët në këtë kontratë, autoriteti kontraktues dhe shoqëria koncesionare, në këtë pikë heqin dorë nga produktet farmaceutike dhe në marrëveshjen e koncesionit parashikohet se: “Palët deklarojnë se heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo pretendim apo kërkesë lidhur me “Produktet farmaceutike”, bazuar në kontratën e koncesionit”.
“*SIPCA Albania*” dhe shoqëria “Mëmë” deklarojnë se nuk kanë shfaqur apo pretenduar dhe nuk do të kenë në të ardhmen asnjë pretendim apo kërkesë ndaj Autoritetit për zbatimin e produkteve të tjera, objekt i kontratës së koncesionit, miratuar me ligjin nr.10381 datë 24.2.2011.”.
- Gjithashtu, shoqëria koncesionare merr përsipër dhe angazhohet të vazhdojë implementimin e teknologjisë aktuale, si dhe ofrohet për të kryer disa përmirësime të kësaj teknologjie në kontratën e koncesionit, duke sanksionuar në dispozitat e amenduara se:

“*SICPA Albania*” dhe shoqëria “Mëmë” angazhohen për vazhdimin e teknologjisë aktualisht të implementuar, bazuar në kontratën e koncesionit, me disa përmirësime teknologjike në fushat e gjykuara si të detyrueshme për funksionalizimin e duhur të saj në thelbin operacional dhe në terren, e konkretisht, duke realizuar:

- a) përmirësime të caktuara, nëse janë të nevojshme, të platformës ekzistuese – *CAPEX*, i kufizuar për të lejuar funksionalizimin dhe operimin e efektshëm të teknologjisë/sistemit aktual.
 - b) nisjen e modulit të ri të raportimit të shërbimeve të të dhënave, që i mundëson autoritetit më shumë analitikë përshkruese, duke u fokusuar në atë që ndodhi në të kaluarën, analitikë diagnostike, që ndihmon në zbulimin e arsyes se pse ndodhën gjërat dhe analitikë parashikuese, që mundësojnë parashikimin e asaj që ka të ngjarë të ndodhë në të ardhmen – aktivizimi + integrimi në platformën ekzistuese;
 - c) asistencë teknike tek autoriteti me të gjithë ekspertizën teknologjike dhe operationale të ekspertëve të Mëmës për vijueshmërinë dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale, 7 muaj para përfundimit të “Afatit”.
- Ky amendim kontrate rregullon dhe një kërkesë të përsëritur vazhdimisht nga autoriteti kontraktor për nevojën aktivizimit digjital të pullave fiskale në momentin që paguhen detyrimet e akcizës, duke përcaktuar se: “Palët angazhohen të punojnë së bashku të zbatojnë aktivizimin digjital të pullave fiskale në momentin që paguhen detyrimet e akcizës bazuar në procedurën e ndryshimit të kontrollit, të përcaktuar në aneksin 16, të kontratës së koncesionit. Kërkesa përkatëse për ndryshim do të bëhet nga Autoriteti, jo më vonë se 10 ditë pas nënshkrimit të kësaj kontrate shtesë. Afatet e zbatimit do të përcaktohen brenda vlerësimit të impaktit, sipas nenit 7, të shtojcës 16, dhe mund të ndryshojë sipas produktit”.

Pika 3 “Të përgjithshme”.

Kjo kontratë shtesë hyn në fuqi në datën e hyrjen në fuqi të ligjit që miraton këtë kontratë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e autoritetit kontraktues, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si përfitues i drejtpërdrejtë i shërbimit të kontrollit të pullave fiskale dhe operimit të këtij shërbimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila, në këtë ndryshim kontrate, luan dhe rolin e autoritetit kontraktues.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikon të ketë efekte për buxhetin e shtetit, pasi nuk paraqet asnjë kosto apo implikim shtesë për zbatimin e saj dhe qeveria shqiptare do të vazhdojë të përfitojë tarifën e koncesionit të barabartë me 2% të të ardhurave vjetore, që realizohen nga shitja e pullave fiskale për të drejtat dhe privilegjet e akorduara në këtë kontratë, sipas pasqyrave financiare të audituara të shoqërisë së koncesionit për çdo vit financiar, deri në datën 31.12.2024.

Projektligji shmang në mënyrë përfundimtare dhe të përvokueshme, çdo dëmshpërblim dhe penaltet që mund të rridhte nga paraqitja e palëve në Gjykatën e Arbitrazhit, duke qenë se të dy palët e kësaj kontrate koncesioni u angazhuan dhe përcaktuan në dispozitat e kësaj kontrate shtesë, heqjen dorë përfundimisht nga çdo pretendim që lidhet me pjesën e pa përmbushur të objektit të kontratës, që lidhet me pullat fiskale të barnave. Gjithashtu, *SIPCA Albania* dhe shoqëria “Mëmë” deklarojnë se nuk kanë shfaqur apo pretenduar dhe nuk do të kenë në të ardhmen asnjë pretendim apo kërkesë ndaj autoritetit për zbatimin e produkteve të tjera, objekt i kontratës së koncesionit, të miratuar me ligjin nr.10381, datë 24.2.2011.

KËSHILLI I MINISTRAVE